

KONTAKT

Adresa:

Justizvollzugsanstalt Essen
c/o Shënoni emrin e të burgosurit
Krawehlstraße 59
45130 Essen

Telefon: 0201 7246-0

Faks: 0201 7246-415

Email: [Kontakt nëpërmjet emailit](#) 

LETËRKËMBIM

Letërkëmbim (të burgosurit)

Letërkëmbimi për të burgosurit rregullohet në nenet 21 - 23, nenet 25, 26 të Ligjit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të Nordrain-Vestfalenit (Nordrhein-Westfalen) (StVollzG NRW). Sipas kësaj, i burgosuri ka të drejtë si rregull të dërgojë dhe të marrë në mënyrë të pakufizuar letra. Administrata e institucionit mund ta ndalojë letërkëmbimin me persona të caktuar nëse

- është rrezikuar siguria dhe rendi i institucionit,
- nëse ka shkaqe për të besuar se kontakti me personat që nuk janë të afërm të të burgosurve sipas nenit 11, paragrafi 1, nr. 1 i Kodit Penal (të Gjermanisë) ka një ndikim të dëmshëm ndaj të burgosurve ose pengon riintegrimin,
- të burgosurit duan të lidhen me viktimat e veprave penale të të burgosurve dhe nga kontakti ka shkaqe për të besuar se do të ketë disavantazhe ndaj viktimave ose palëve të treta të rrezikuara ose u kanë kundërshtuar atyre marrjen e kontaktit.

Çdo postë hyrëse dhe dalëse i nënshtrohet një kontrolli vizual sipas nenit 22, paragrafi 1 i StVollzG NRW për objekte të ndaluara si për shembull para, karta SIM ose droga. Përveç kësaj, sipas nenit 22, paragrafi 2 i StVollzG NRW, letërkëmbimi duhet të mbikëqyret si rregull për arsye të trajtimit ose të sigurisë dhe rendit. Megjithatë, neni 26 StVollzG NRW përjashton nga ka kjo marrës ose dërgues të caktuar, si për shembull avokate ose avokatë, përfaqësues të popullit, institucionet e apelit, kontrolluesit për mbrojtjen e të dhënave dhe zyrtarët e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore. Në këtë mënyrë zbatohet sekreti i letërkëmbimit i mbrojtur me ligjin themeltar – edhe pse jo në mënyrë të pakufizuar – edhe për të burgosurit.

Kostot postare i mbulon i burgosuri.

Letërkëmbimi (të paraburgosurit)

Rregullimi për letërkëmbimin e të paraburgosurve gjendet në nenin 20 të Ligjit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të paraburgimit të Nordrain-Vestfalenit (Nordrhein-Westfalen) (UVollzG NRW). Sipas kësaj, i paraburgosuri si rregull mund të dërgojë dhe marrë letra në mënyrë të pakufizuar.

Si rregull, kontrolli i letrave bëhet vetëm nëse urdhërohet shprehimisht nga një gjyqtar për mbrojtje nga rreziku i ikjes, rreziku i prishjes së provave dhe rreziku i përsëritjes së veprës penale.

Kostot postare i mbulon i paraburgosuri.

VIZITA


Për personat privatë:

Dita e javës:	Ora:	Lloji i vizitës:
E hënë	13:00 - 15:00	Vizitë individuale (mbikëqyrje optike dhe akustike)
E martë	8:40 - 15:10	Vizitë individuale (mbikëqyrje optike dhe akustike)
E enjte	8:00 - 15:10	Vizitë individuale (mbikëqyrje optike dhe akustike)
E hënë	08:30 - 14:30*	Vizitë e përbashkët (mbikëqyrje optike)
E mërkurë	11:15 - 20:30*	Vizitë e përbashkët (mbikëqyrje optike)
E shtunë (vetëm një të shtunë në muaj)	08:00 - 14:00	Vizitë e përbashkët (mbikëqyrje optike)
E premte, e diele, dhe ditë jave festash	mbyllur	

* Takimet e fundit fillojnë të hënave në orën 14:30 dhe të mërkurave në orën 17:15!

Koha e vizitës është dy orë në muaj, e ndarë në dy vizita me një kohëzgjatja 60 minuta secila. Për vizitat për **të paraburgosurit** nevojitet një leje vizite përkatëse nga gjykata kompetente.

Në raste të veçanta, për **të burgosurit** vizita mund të zgjasë më gjatë. Për këtë nuk nevojitet leje nga gjyqtari.

Për vizitat individuale – dhe të përbashkëta duhet të caktohen takime me punonjësit e kartelës së vizitës. Ata mund t'i gjeni të hënave nga ora 10:30 dhe 18:30. Të martave dhe të enjteve nga ora 09:00 - 15:00 (pushimi i drekës: ora 12:00 – 13:00) dhe të mërkurave nga ora 12:00 – 19:00 në numrin e telefonit 0201 / 7246 -156. Por, takimet e vizitave mund të caktohen edhe me email (besuch@jva-essen.nrw.de ).

Çdo vizitor duhet të paraqesë një kartë identiteti ose pasaportë të vlefshme dhe, për të paraburgosurit, edhe një leje vizite nga gjykata kompetente. Të ashtuquajturit leje të përkohshme ("Fiktionsbescheinigung") mund të pranohen vetëm nëse janë lëshuar mbi bazën e një dokumenti të vlefshëm identifikimi të një shteti tjetër. Nëse leja e përkohshme ("Fiktionsbescheinigung") është lëshuar vetëm mbi bazën e të dhënave të poseduesit, atëherë hyrja refuzohet. E njëjta gjë vlen edhe për kartat e identitetit dhe pasaportat që kanë skaduar.

Leje të tilla si dhënia e sendeve nga dhoma e sendeve personale ose dorëzimi i sendeve, lëshimi i një prokure, etj., për të paraburgosurit duhet të shënohen nga gjyqtari në lejen e vizitës dhe, për të burgosurit, duhet të lëshohen nga institucioni. Sendet për të burgosurit duhet të lejohen para se të futen. Dorëzimi i sendeve të palejuara ose të ndaluara mund të dënohet si kundravajtje me ndalim vizite ose me gjobë.

Pavarësisht nga kjo, dhënia e paketave të paketuara të burgosurve është e lejuar gjatë vizitës. Këto paketa mund të blihen nga gardiani i vizitës. Paketat disponohen në vlerën 10 euro dhe 20 euro, ku 20 euro paraqet vlerën maksimale për blerjen. Lutemi, sillni shumat e numëruara dhe në kartëmonedha, nëse është e mundur.

Në dhomat e vizitës së përbashkët dhe individuale të institucionit ndalohet rreptësisht duhani.

Me rëndësi: Vizita e së shtunës bëhet **vetëm të shtunën e parë të muajit**. Përveç kësaj, për arsye organizative tejkalimi i kohëzgjatjes së vizitës prej 60 minutave nuk është i mundur!

Me rëndësi: Personat që mbajnë **pejsmejker** duhet ta tregojnë këtë gjë në momentin e kontrollit!!

VIZITA ME FËMIJËT

Për fëmijët e mitur, burgosja e një prindi përbën një ngarkesë veçanërisht të madhe. Edhe prindërit e burgosur vihen përpara detyrës së vështirë që të mbajnë ose të ndërtojnë një kontakt të besueshëm me fëmijën gjatë burgosjes. Për këtë arsye, në Nordrain-Vestfalen mbështeten në mënyrë të veçantë kontaktet familjare, veçanërisht me fëmijët e mitur. Në këtë mënyrë, për fëmijët e mitur ka një kontigjent shtesë vizite të parashikuar me ligj. Përveç kësaj, Nordrain-Vestfalen përpiqet që të mbajë parasysh nevojat e fëmijëve të mitur gjatë vizitës.

Broshurë informuese

PËRSHKRIMI I RRUGËS:

Me rrjetin e transportit publik:

- Nëse udhëtoni me tren, atëherë merrni U15 nga Essen Hbf deri në stacionin Gemarkenplatz. Rruga lidhëse me këmbë (rreth 5 min.): Në rrugën Brunostraße (majtas pranë filialit të Deutschen Bank), pastaj rrugën e 2-të djathtas në rrugën Krawehlstraße.
- Ose me rrjetin brenda qytetit me tramvajin (linja 106) deri në stacionin Landgericht. Rruga lidhëse me këmbë (rreth 3 min.): në rrugën Virchowstraße (majtas nga Landgericht (Gjykata e Landit) dhe Prokurorisë së re (Staatsanwaltschaft), pastaj rrugën e parë djathtas në rrugën Krawehlstraße.

Udhëtimi me veturë:

- Nëpërmjet autostradës A52, p.sh. në drejtimin e Düsseldorf deri në daljen e autostradës Essen-Rüttenscheid, pastaj nëpërmjet B224 në drejtimin "Zentrum" (qendër). Pas rreth 1900 metrash majtas në rrugën Krawehlstraße.
- Nëpërmjet autostradës A40, që vjen nga Bochum-i deri në daljen e autostradës "Stadtmitte" (qendra e qytetit), në drejtim të Holsterhausen, rreth 1600 metra, majtas në rrugën Virchowstraße, rreth 200 metra majtas në rrugën Krawehlstraße.
- Nëpërmjet autostradës A40 nga Duisburg-u deri në daljen e autostradës Holsterhausen/Altendorf, pastaj djathtas dhe në semaforin e 3-të majtas në rrugën Holsterhauser Straße, pas rreth 500 metrash djathtas në rrugën Virchowstraße dhe pas 200 metrave të tjera majtas në rrugën Krawehlstraße.

TË DHËNAT BANKARE

Shumat në para mund të transferohen vetëm në llogarinë bankare të JVA-së:

Marrësi:	JVA Essen
Banka:	Postbank Essen
BIC:	PBNKDEFF
IBAN:	DE83 3601 0043 0003 1094 32

Qëllimi i përdorimit: Mbiemri, emri, datëlindja e të burgosurit

Udhëzim i rëndësishëm:

Për të gjitha transfertat për të burgosuri qëllimi i përdorimit duhet të përmbajë emrin e plotë dhe datëlindjen. Nëse njihet, si informacion shtesë mund të jepni edhe numrin e regjistrimit të të burgosurit. Pagesat në të holla mund të bëhen vetëm menjëherë para çdo vizite në zyrën e pagesave. Dërgimi i parave të holla në letra ose dhënia direkt të të burgosurit **nuk** lejohet.

MBROJTJA E TË DHËNAVE

Broshurë informuese